



AKTI I THEMELIMIT & STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ALNED 91” SHPK

Sot me date 22.12.2017 para meje notere Gentiana SHKODRA, me studio ne Tirane, ne adresen e larttreguar, u paraqiten personalisht:

1. **Z. Edmond BLLAKO**, i biri i Arqile dhe Dhora, lindur ne Permet, me 04.04.1960, banues ne Tirane, Rruga e Kavajes, P.141/7, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. G00404141L
2. **Z. Taned BLLAKO**, i biri i Edmondit dhe Kostances, lindur ne Erseke, me 23.08.1983, banues ne Tirane, Rruga e Kavajes, P.141/7, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. J30823062C

Permes ketij akti po themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin shoqeror “ALNED 91,, Sh.p.k., me seli ne adresen: Erseke, Rruga “Ropi Stillo Gostivishti,, fabrika e Birres “ ALNED 91,, kati i dyte, Erseke, Shqiperi.

2) Shoqeria ka si objekt te aktivitetit te saj:

- Marrja pjese dhe dhenia e asistences e trajnimeve ne fushen e informatikes. Shitja e blerja e pajisjeve TI - Teknologjise se informacionit te tilla si kompjutera, laptope, servera, projektore, kamera dixhitale, skaner, printera, fotokopje, fakse, etj.
- Krijimi i linjave per montimin e kompjuterave dhe studiove dixhitale. Sigurimi i pjeseve te kembimit per te gjitha llojet e pajisjeve te tilla dhe realizimi i sherbimit te mirembajtjes, garancise e te riparimit. Realizimi i projektimit dhe instalimit te rrjeteve kompjuterike, informatike dhe mirembajtjen e tyre.
- Realizimi i projektimit dhe instalimit te sistemeve te menazhimit elektronik, elektrik dhe te sigurise se ndertesave.
- Programim programe implementimi i sistemeve dhe programeve informatike (software-ve),
- Mirembajtje sistemesh dhe programesh informatike, asistence dhe konsulence per pergatitjen e programeve informatike (software-ve).
- Perpunimi i te dhenave ne kompjuter e pajisje te tjera me synim realizimin e sherbimeve te tilla si pergatitje faqe interneti, pergatitje reklamash, posterash, ftesash, kartvizitash, e deri ne shtypje e lidhje libri.
- Kryerja e veprimtarive te tjera tregtare si shitja dhe blerja me shumice dhe pakice te artikujve te kancelarise, pajisje elektrike dhe elektronike shtepiake, etj.
- Shitja dhe blerja e sistemeve kompiuterike e informatike me qellim perdorimi dhe menazhimi te sistemit bankar. Realizimi i import-eksportit te te gjitha artikujve te permendur me siper.
- Aktivitete te tjera te lejueshme sipas legjislacionit ne fuqi.
- Sherbime informatike te ndryshme te aplikueshem ne sektore te ndryshem.
- Programim faqesh internet (Web Design-Development) si dhe mirembajtjen e tyre. Tregtim te programeve informatike (softwareve). Programim dhe zhvillim te aplikacioneve web-based.
- Instalime mirembajtje paisjesh teknike, speciale (kaldaja, kondicionier, sistemet e ngrohjes, gjeneratore, etj).
- Krijimi i dhomave te serverave
- Prodhim dhe Tregtimi i birres per tregun e brendshem dhe te jashtem.

- Importi, blerja dhe shitja e lendeve te para dhe ndihmese per prodhimin e birres. Importimi, blerja dhe shitja e ambalazheve per ambalazhimin e birres dhe promovimin e shitjes se saj. Prodhimi, importimi, blerja dhe shitja e gazit karbonik.
- Kryerja e te gjitha operacioneve dhe veprimtarive tregtare, industriale, investuese dhe financiare qe lidhen drejteperdrejt ose terthorazi me objektin e veprimtarise se shoqesise dhe qe jane te nevojshem per relizimin e objektit te mesiperm te veprimtarise se shoqerise.
- Hapja e veprimtarive dhe krijimi i shoqerive te reja si dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera brenda dhe jashte vendit, ne perputhje me normat e legjislacionit ne fuqi.

3) Afati i veprimtarise se shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe kohe te pacaktuar dhe shoqeria mund te shperbehet ne cdo kohe, me vendimin e asamblese se pergjithshme te ortakeve.

4) Kapitali shoqeror ka vleren 100 (njeqind) leke dhe perbehet nga 2 kuota te derdhura teresisht, te mbajtura nga ortaket e shqerise si ne vijim:

1. Z. Edmond BLLAKO – kontribuon me 50% te kapitalit, baraz me 1 kuote, me vlere nominale prej 50,00 leke
2. Z. Taned BLLAKO - kontribuon me 50% te kapitalit, baraz me 1 kuote, me vlere nominale prej 50,00 leke

5) Shoqeria do te administrohet nga administratori i vetem te cilit i jane dhene te gjitha kompetencat e drejtimit te zakonshem.

Administratori i vetem qendron ne detyre per nje mandat 5 – vjecar dhe per sa kohe nuk eshte revokuar nga asambleja e ortakeve, si organi me i larte vendimmarres ne shoqeri.

Me kete akt, administrator i pare i shoqerise emerohet Znj. Aferdita MEKSI, e bija e Arqile dhe Dhora, lindur ne Permet, me 15.02.1964, banuese ne Erseke, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit nr. G45215096F.

6) Vitet ushtrimore mbylLEN me 31 dhjetor te cdo viti. Viti i pare ushtrimor mbyllet me 31 dhjetor 2018.

7) Vendbanimi fiskal i ortakeve do te jete selia e shoqerise per cdo efekt ligjor.

8) Autorizohet Znj. Bariona LYBESHARI te kryeje cdo procedure te konsideruar te vlefshme dhe te nevojshme per regjistrimin e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Ky akt themelimi eshte hartuar ne Tirane ne pese ekzemplare me vlere te njejte ligjore.

Shoqeria krijohet dhe do te ushtroje aktivitet ne perputhje me ligjet shqiptare ne fuqi, ligjit n. 9901 date 14.04.2008 dhe ligje te tjera qe do te jene ne fuqi gjate periudhes se aktivitetit te shoqerise, si dhe ne perputhje me statutin qe konsiderohet pjese perberese e ketij akti.

Lexuar, gjetur konform vullnetit te lire e te pavesuar, pranuar dhe nenshkruar nga ortaket e shoqerise ne pranine e noterit:

ORTAKET THEMELUES

NOTERE

EDMOND-BLLAKO
EDMOND BLLAKO

Gentiana Shkodra
GENTIANA SHKODRA

TANED BLLAKO
TANED BLLAKO

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ALNED 91” SHPK
(ne zbatim te ligjit n. 9901 date 14.04.2008)

Sot me date 22.12.2017, ne Tirane, ortaket themelues:

1. **Z. Edmond BLLAKO**, i biri i Arqile dhe Dhora, lindur ne Permet, me 04.04.1960, banues ne Tirane, Rruga e Kavajes, P.141/7, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. G00404141L
2. **Z. Taned BLLAKO**, i biri i Edmondit dhe Kostances, lindur ne Erseke, me 23.08.1983, banues ne Tirane, Rruga e Kavajes, P.141/7, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. J30823062C

Vendosin te perpilojne statutin e Shoqerise, qe do te rregullohet permes klauzolave vijuese:

KAPITULLI I
THEMELIMI, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1 – Emri

Me ane te ketij akti eshte themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “ALNED 91” Sh.p.k nga ortaket Edmond BLLAKO dhe Taned BLLAKO.

Emri i shoqerise do te shfaqet ne te gjitha aktet e nxjera ne emer dhe per llogari te shoqerise. Ketu e ne vijim “ALNED 91” do t'i referohemi si “Shoqeria”.

Neni 2 – Objekti i Shoqerise

Objekti i shoqerise perfshin aktivitetet si ne vijim:

- Marrja pjese dhe dhenia e asistences e trajnimeve ne fushen e informatikes. Shitja e blerja e pajisjeve TI - Teknologjise se informacionit te tilla si kompjutera, laptope, servera, projektore, kamera dixhitale, skaner, printera, fotokopje, fakse, etj.
- Krijimi i linjave per montimin e kompjuterave dhe studiove dixhitale. Sigurimi i pjeseve te kembimit per te gjitha llojet e pajisjeve te tilla dhe realizimi i sherbimit te mirembajtjes, garancise e te riparimit. Realizimi i projektimit dhe instalimit te rrjeteve kompjuterike, informatike dhe mirembajtjen e tyre.
- Realizimi i projektimit dhe instalimit te sistemeve te menazhimit elektronik, elektrik dhe te sigurise se ndertesave.
- Programim programe implementimi i sistemeve dhe programeve informatike (software-ve),
- Mirembajtje sistemesh dhe programesh informatike, asistence dhe konsulence per pergatitjen e programeve informatike (software-ve).
- Perpunimi i te dhenave ne kompjuter e pajisje tet jera me synim realizimin e sherbimeve te tilla si pergatitje faqe interneti, pergatitje reklamash, posterash, ftesash, kartvizitash, e deri ne shtypje e lidhje libri.
- Kryerja e veprimtarive te tjera tregtare si shitja dhe blerja me shumice dhe pakice te artikujve te kancelarise, pajisje elektrike dhe elektronike shtepiake, etj.
- Shitja dhe blerja e sistemeve kompiuterike e informatike me qellim perdorimi dhe menazhimi te sistemit bankar. Realizimi i import-eksportit te te gjitha artikujve te permendur me siper.
- Aktivitete te tjera te lejueshme sipas legjislacionit ne fuqi.
- Sherbime informatike te ndryshme te aplikueshem ne sektore te ndryshem.



- Programim faqesh internet (Web Design-Development) si dhe mirembajtjen e tyre. Tregtim te programeve informatike (softwareve). Programim dhe zhvillim te aplikacioneve web-based.
- Instalime mirembajtje paisjesh teknike, speciale (kaldaja, kondicionier, sistemet e ngrohjes, gjeneratoreetj).
- Krijimi i dhomave te serverave
- Prodhimi dhe Tregtimi i birres per tregun e brendshem dhe te jashtem.
- Importi, blerja dhe shitja e lendeve te para dhe ndihmeseper prodhimin e birres. Importimi, blerja dhe shitja e ambalazheve per ambalazhimin e birres dhe promovimin e shitjes se saj. Prodhimi, importimi, blerja dhe shitja e gazit karbonik.
- Kryerja e te gjitha operacioneve dhe veprimtarive tregtare, industriale, investuese dhe financiare qe lidhen drejteperdrejt ose terthorazi me objektin e veprimtarise se shoqesise dhe qe jane te nevojshem per relizimin e objektit te mesiperm te veprimtarise se shoqerise.
- Hapja e veprimtarive dhe krijimi i shoqerive te reja si dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera brenda dhe jashte vendit, ne perputhje me normat e legjislacionit ne fuqi.

Neni 3 – Selia

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Erseke, Rruga "Ropi Stillo Gostivishti,, fabrika e Birres "ALNED 91,, kati i dyte, Erseke, Shqiperi.

Vende te tjera te ushtrimit te aktivitetit jane ne adresat:

- Tirane Tirane TIRANE Rruga e Kavajes, Pallati "Sinani", magazine, kati perdhe (ambient me sipërfaqe 40 m2, me orientim nga veriu, i ndodhur ne katin perdhes te objektit 8 kat ne Rrugen e kavajes, ndertuar nga Shoqeria e Ndertimit "SINANI" shpk.)
- Tirane Tirane TIRANE Automjet me targe TR 75-74 U
- Tirane, Tirane, TIRANE Automjet Mercedes Benz me targa AA 450 PM
- Tirane Tirane TIRANE Automjet Mercedes Benz Sprinter Furgon me frigorifer AA 313 GO
- Tirane Tirane TIRANE Automjet Honda CR-V me targe TR 5666 S

Asambleja e Ortakeve, me shumice te kualifikuar mund te vendose hapjen e filialeve, degeve dhe perfaqesive te Shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise si dhe jashte saj.

Neni 4- Adresa

Adresa zyrtare e ortakeve per cdo marredhenie lidhur me shoqerine eshte adresa qe do te rezultoje nga libri i ortakeve.

Neni 5 - Kohezgjatja e veprimtarise

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe kohe te pacaktuar dhe shoqeria mund te shperbehet ne cdo moment me vendimin e asamblese se pergjithshme te ortakeve.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT

Neni 6- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 (njeqind) leke dhe mund te rritet ne baze te modaliteteve ligjore.

Neni 7- Vlera e kuotave dhe pjesemarrja




Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 2 (dy) kuota, te paguara teresisht, te mbajtura nga ortaket e shoqerise ne kete menyre:

1. Z. Edmond BLLAKO – kontribuon me 50% te kapitalit, baraz me 1 kuote, me vlere nominale prej 50 leke
2. Z. Taned BLLAKO - kontribuon me 50% te kapitalit, baraz me 1 kuote, me vlere nominale prej 50 leke

Neni 8- Transferimi i kuotave

Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve. Transferimi i kuotave ndaj te treteve – jo ortake, ne cdo rast, do t'i nenshtrohet respektimit se te drejtes se parablerjes. E drejta e parablerjes i perket cdo ortaku, ne proporcion me kuotat e mbajtura dhe duhet te ushtrohet brenda 30 diteve nga oferta e njoftuar nga ortaku qe ka vullnet per shitjen e kuotave dhe t'i komunikohet ortakeve sipas nenit 4.

Ne rast mosekzekutimi te se drejtes se parablerjes brenda 30 diteve nga oferta, kuotat mund t'i transferohen paleve te treta.

Neni 9 – Rritja e kapitalit

Ne rast rritje te kapitalit, kontributet do te ofrohen nga ortaket ne proporcion me kapitalin e poseduar prej secilit prej tyre.

Neni 10 – Financimet

Financimet e bera nga ortaket, ne proporcion me kuotat e mbajtura dhe ne perputhje me vendimet e asamblese, jane te lira nga interesat.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL

Neni 11 – Asambleja e ortakeve dhe kompetencat e saj

11.1 Organi vendimmarres i Shoqerise eshte Asambleja e ortakeve.

11.2 Vendimet e Asamblese se Shoqerise, per te cilat kerkohet nje shumice e thjeshte, jane te vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne me shume se 31 (tridhjetete e nje) % te te gjithë kapitalit themeltar.

11.3 Vendimet e Asamblese se Shoqerise, per te cilat kerkohet nje shumice e kualifikuar, jane te vlefshme nese jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne te pakten 51% te te gjithë kapitalit themeltar.

Neni 12 – E drejta e pjesemarrjes se votes

12.1 Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamble dhe te paraqese mendimin e tij dhe te japi aq vota sa eshte numri i kuotave te kapitalit qe ai zoteron.

12.2 Cdo ortak ka te drejte qe te perfaqesohet nga nje person tjeter dhe jo-ortak, i pajisur me prokure me shkrim, me anen e se ciles do te jape voten e tij.

12.3 Ortaku nuk mund te leshoje prokure per votim per nje pjese te kuotave te kapitalit qe ai zoteron, ne qofte se voton personalisht per pjesen e mbetur te kuotave.

Neni 13- Thirrja e asamblese se Ortakeve



13.1 Asambleja e Ortakeve thirret te pakte nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e bilanci, te raportit te Administratorit, ekspertit kontabel si dhe inventarit.

13.2 Asambleja mund te thirret ne cdo moment nga nje prej administratoreve ose nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne me shume se 5 % te kapitalit themeltar.

13.3 Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande me kthim pergjigje qe duhet t'u dergohet ortakeve ne adresen qe rezulton ne Librin e Ortakeve dhe ekspertit kontabel, nese eshte emeruar, te pakten 7 dite para mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te permbaje informacion mbi llojin e Asamblese, si dhe ceshtjet qe do te trajtohen dhe per te cilat do te merret vendim, mbi vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte.

13.4 Asambleja mund te thirret dhe jashte selise se shoqerise.

13.5 Mbledhjet e Asamblese mund te mbahen dhe nepermjet telekonferences dhe videokonferences, me kusht qe te gjitha pjesemarresit te mund te identifikohen dhe t'i lejohet te ndjekin diskutimin dhe te nderhyjne ne momentin e trajtimit te argumenteve, pasi te jene verifikuar keto kerkesa qe duhet te rezultojne ne procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet ne vendin ku ndodhet kryetari dhe sekretari i mbledhjes.

13.6 Asambleja do te thirret dhe mbahet rregullisht dhe pa respektimin e formaliteteve te njoftimit, ne rast se jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar.

13.7 Cdo Asamble do te drejtohet nga nje ortak ose ndonje person tjeter i caktuar nga e njejta Asamble. Per pasqyrimin e vendimit, Asambleja emerone nje sekretar, qe mund te jete dhe jo-ortak.

13.8 Vendimet e Asamblese duhet te nenshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

14.1 Shoqeria administrohet nga 1 (nje) administrator, i cili qendron ne detyre deri ne revokim apo doreheqje, per nje periudhe maksimale prej 5 (pese) vjetesh.

14.2 Perfaqesimi ligjor do t'i besohet administratorit **Znj. Afërdita MEKSI**, shtetase shqiptare, e bija e Arqile dhe Dhora, lindur ne Permet, me 15.02.1964, banuese ne Erseke, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit nr. G45215096F

Administratori do te ushtroje te gjitha kompetencat sipas parashikimeve te nenit 95 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".

14.3 Administratori mund te emeruje perfaqesues te posacem per akte te vecanta ose per kategori aktesh.

Neni 15- Eksperti kontabel i autorizuar

15.1 Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e ortakeve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel te shoqerise mund t'i besohet nje eksperti kontabel te autorizuar.

15.2 Eksperti kontabel i licensuar mund te shkarkohet sipa smenyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 16



16.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te secilit vit.

16.2 Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar dhe perfundon me 31 dhjetor 2017.

16.3 Bilancet vjetore, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar, nese eshte emeruar, miratohen nga Asambleja me shumicen e percaktuar sipas ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".

16.4 Miratimi i dokumenteve qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 muajve nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet dhe marreveshja e ortakeve

17.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% te destinuar per rezerven ligjore deri ne 10% te kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu te gjitha shumat qe Asambleja vendos te vere menjane, u shperndahen ortakeve ne proporcion me kuotat e kapitalit themeltar te zoteruara.

17.2 Asambleja mund te vendose dhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo per shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

KAPITULLI V SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 18 – Prishja

18.1 Shoqeria priset me ane te Vendimit te Asamblese se Ortakeve, me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.

18.2 Shoqeria nuk priset ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, pazotesise juridike, vdekjes ose falimentimit te njerit ose disa ortakeve.

Neni 19 – Likuidimi

19.1 Ne rast prishje, shoqeria duhet te likuidohet.

19.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja emeron nje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivit te shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshem per te perfunduar likuidimin.

19.3 Me perfundimin e procedures se likuidimit, Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.

19.4 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do te shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne proporcion me kuotat e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 20- Zgjidhja e mosmarreveshjeve

20.1 Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij satuti dhe aktit te themelimit, si dhe ato qe mund te lindin ne pergjithesi midis ortakeve (pervec atyre personale dhe jashte shoqerise) ose midis nje apo me shume ortakeve te shoqerise, do te zgjidhen ne menyre miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejteperdrejte ndermjet paleve te interesuara.

20.2 Ne rast se nuk arrihet nje zgjidhje miqesore te mosmarreveshjes, ato do t'i besohen Gjyqatese Rrethit Gjyqesor Tirane.



Neni 21 – Gjuha

22.1 Ky statut eshte i perbere nga 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe.

Lexuar, gjetur konform vullnetit te lire e te pavesuar, pranuar dhe nenshkruar nga ortaket themelues ne pranine e noterit:

ORTAKET THEMELUES


EDMONA-BLLAKO
EDMOND BLLAKO



TANED BLLAKO
TANED BLLAKO



Deklaroj une, notere Gentiana Shkodra se dhashe asistencen legale dhe perpilova Aktet si me lart dhe se palet, per identitetin e te cilave jam e bindur nga dokumentat perkatese te identifikimit, nenshkruan rregullisht ne thember te aktit te mesiperm. E legalizoj aktin sipas ligjit. Prodhuar ne pese ekzemplare me vlere te njejte ligjore.


GENTIANA SHKODRA / Notere